REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORË
SEKTORI I ZHVILLMIT URBAN

Nr. 948/1 prot.

Vlorë, më 27.04.2026

Lënda: Kërkesë për informacion.

BASHKISË SARANDË

Per dijeni: **MARJANA KOÇI**

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë është administruar ankesa e znj. Marjana Koçi, e përcjellë nga Nënprefekti i Sarandës, nëpërmjet së cilës kundërshtohet ligjshmëria e shkresës së Bashkisë Sarandë nr. 5370, datë 07.07.2026, me objekt "Njoftim për plotësimin e dokumentacionit" lidhur me kërkesën për Leje Zhvillimi.
Në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në përputhje me Ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", si dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, Prefekti i Qarkut Vlorë kërkonë informacion dhe dokumentacion të plotë nga Bashkia Sarandë për të vlerësuar rrethanat e çështjes.
Për sa më sipër, lutemi të na përcillni brenda 5 (pesë) ditëve pune:

1. Kopjen e plotë të dosjes administrative që lidhet me aplikimin nr. AN080420260108, datë 08.04.2026.
2. Raportin teknik dhe juridik mbi shqyrtimin e kërkesës.
3. Të gjitha aktet, njoftimet, komunikimet elektronike ose shkresore të kryera me aplikantin gjatë procedurës.
4. Arsyetimin e plotë ligjor dhe teknik që ka çuar në nxjerrjen e shkresës nr. 5370, datë 07.07.2026.
5. Informacion nëse gjatë afatit të shqyrtimit janë kërkuar plotësime dokumentacioni, datën e tyre dhe mënyrën e njoftimit të subjektit.
6. Sqarim nëse procedura administrative është konsideruar e përfunduar, pezulluar apo vijon ende dhe bazën ligjore mbi të cilën mbështetet ky vlerësim.
7. Çdo dokument tjetër që vlerësohet i nevojshëm për sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes.


Adresa: Lagj. "H. Çakërri" Rr. "S. Delvina" Vlorë, Tel/Fax 33 424105 E-mail Prefekti.Vlore@mb.gov.al

Dokumentacioni i kërkuar është i domosdoshëm për të mundësuar një shqyrtim të plotë dhe objektiv të ankesës.

Duke ju falenderuar !

P R E F E K T I

Evis Allushi



Adresa: Lagj. "H. Çakërri" Rr. "S. Delvina" Vlorë, Tel/Fax 33 424105 E-mail Prefekti.Vlore@mb.gov.al